



Lajmet e Fundit:

Mat – Vijon operacioni policor antikanabis “Ulëza”, shkon në 6 numri i personave të arrestuar



Lajmet

19/02/2021

Durrës – Goditet një tjetër rast i armëmbajtjes pa leje dhe i sendeve të kundërligjshme në banesë

Strukturat e DVP Durrës vijnë në punën për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë.

Goditet një tjetër rast i armëmbajtjes pa leje dhe i sendeve të kundërligjshme në banesë.

Sekuestrohen një armë zjarri pushkë dhe kallëpe me lëndë plasëse, arrestohet në flagrancë poseduesi i tyre.

Arrestohen në flagrancë dhe 4 shtetas të tjerë, për vepra të ndryshme penale.

Specialistët e Policimit në Komunitet, në vijim të punës për parandalimin e përshkallëzimit të dhunës në familje, pas një telefonate të marrë në Sallën Operative, se në lagjen nr. 14, Durrës, në një familje kishte konflikt familjar, menjëherë kanë shkuar në adresën e dhënë, ku kanë konstatuar shtetasin I. T., i cili ishte në gjendje të dehur.

Pas kontrollit të ushtruar nga shërbimet e Policisë në banesën e tij janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri pushkë, 3 kallëpe me lëndë plasëse, 3 radio dhënëse-marrëse dhe 1 kapsollë me 2 fije elektrike.

Në vijim të veprimeve, nga specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Durrës u arrestua në flagrancë shtetasi I. T., 51 vjeç, banues në Durrës, për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe e municionit”.

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Krujë arrestuan në flagrancë shtetasit:

Xh. M., 53 vjeçe, H. B., 55 vjeç, D. M., 61 vjeç, banues në Fushë Krujë, pasi janë konfliktuar me njëri-tjetrin duke ushtruar dhunë fizike.

Po nga specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Krujë u arrestua në flagrancë për veprën penale “Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i rrugëve automobilistike”, shtetasi S. P., 50 vjeç, banues në Fushë Krujë, pasi u konstatua duke shkatërruar ish-linjen hekurudhore në Krujë.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Share

Share

Share

Share

Email

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Fier – Zbardhet dhe dokumentohet me prova vrasja e shtetasit Sh. K., ndodhur më datë 01 shkurt 2021, në Fier. Identifikohen dhe shpallen në kërkim 4 autorët e dyshuar të ngjarjes kriminale

Mat – Vijon operacioni policor antikanabis “Ulëza”, shkon në 6 numri i personave të arrestuar ▶